

Ju përshëndes dhe ju falënderoj të gjithëve që gjetët arsye të jeni në këtë forum.

Ashtu si kolegu Haxhia ju prezantoi, kjo është një nismë që synon hapjen e një etape të re për profesionet e lira në Shqipëri. Hap një etapë të re, duke mbyllur qasjen e rrugëtimit tonë të derisotëm.

Ky forum, kjo nismë, kemi menduar të ketë një pjesëmarrje të gjerë përtej 4 profesioneve tona dhe mbi të gjitha një frymë pozitiviste.

Nuk do të flasim për tatimin antikushtetues 15 apo 23% që hyri në fuqi këtë fillimvit e as për përshtjellimin gjithëprofesional që shkaktoi ai, pasi nuk besojmë se thjesht evidentimi goditës i problemeve që kemi të gjithë si profesione të lira do të ndihmonte në sistemimin e tyre. Por, nga ana tjetër, as fataliteti i shprehjes “Është e kotë – s’ të dëgjon njeri... bërtit sa të duash”, nuk i shkon më për shtat qëndrimin që kemi mbajtur deri sot e aq më pak kësaj iniciative. Për më tepër, nuk do t’u përshtatej aspak kohëve sfiduese që na presin përpara e që fillojnë shumë shpejt me vitin 2025.

Harta e cunguar gjyqësore e avokatisë; RNSH-ja problematike e noterisë; mikrokreditë sadiste “të përmbarrimit” apo marrëveshja “televizive” e ndërmjetësimit mund të jenë lokomotiva e shfaqjes së një treni shumë të gjatë problematik, me vagonë të mbushur plot me histori kontabilistësh, vlerësuesish, arkitektësh, mjekësh, infermierësh apo veterinerësh.

Treni i profesioneve të lira në Shqipëri ka 26 “vagonë” aktivitetesh, të ndarë në 169 kompartamente profesionesh brenda tyre. Treni goxha i gjatë profesional, i emërtuar sipas VKM-së 753 të 20 dhjetorit 2023 e që duket shumë pompoz kur e sheh (kemi shumë profesione të lira, apo jo?), por që rend mbi trase apo shina të pasigurta.

Të gjitha profesionet e lira, jo vetëm ato ligjore, janë krijuar të garantojnë përmbushjen e nevojave, kërkesave apo të drejtave të qytetarëve, t’u shërbejnë atyre, por kjo kërkon vëmendje nga aktorët dhe faktorët që i krijuan këto profesione, e jo thjesht ekzistencë në letër, ligj apo VKM.

Nga ana tjetër, domethënë nga ana jonë – si interpretuesit e këtyre profesioneve, kërkohet që të jemi në lartësinë e duhur për t’u përgjigjur kërkesave publike dhe mbi të gjitha për të merituar titujt që na janë dhënë.

Dhe kemi marrë goxha tituj... duke dashur t’i numërojmë pa pasur një shifër të saktë për përmbarruesit privatë, noterët, avokatët dhe ndërmjetësit, jemi mbi 3 mijë... Por, nëse numërohen të gjithë përtej 4 profesioneve tona ligjore, do të krijohej një “ushtri” jo e vogël shërbyesish publikë me mbi 10 mijë profesionistë.

Ndaj, dhe kjo “ushtri” profesionistësh ka nevojë të konsiderohet për fuqinë që ka; për fuqinë pozitive e jo të eklipsohet vetëm nga sensacionet e ngjarjeve negative.

Kjo është edhe arsyeja që e thirrëm këtë forum.

Promovimi pozitiv dhe bashkëpunimi për ndërgjegjësimin publik mbi rëndësinë e profesioneve të lira në Shqipëri tashmë është kthyer në imperativ. Ne kemi nevojë të vlerësohemi në tërësinë tonë

për atë çka jemi, për atë çka ofrojmë pozitive në shoqëri; publiku ka nevojë të njihet me “bëmat” tona pozitive; ndërsa faktorët e pushtetit nevojitet të na konsiderojnë nga sot me shumë seriozitet.

Si hap pararendës të këtij forumi - Ne - katër profesionet e lira ligjore, nënshkruam më 20 dhjetor një memorandum bashkëpunimi, mes katër Dhomave tona, me anë të të cilit formalizuam një angazhim të përbashkët me 5 objektiva, ku ndër më të rëndësishmit renditet objektivi – “Për inkurajimin e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e profesioneve të lira ligjore dhe rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe bizneseve”.

Por, ndërgjegjësimi publik duhet të ecë paralel me vëmendësimin qeveritar, sepse tashmë kemi hyrë në epokën dixhitale, ku nuk është sofistikuar vetëm ndërveprimi i informacionit, por edhe vetë ndërgjegjësia qytetare.

Njerëzit tashmë janë të qartë për çka duan, për shërbimin që duan, për se si u ofrohet ai, për cilësinë, vlerën e gjithçka tjetër që i bën të vlerësojnë me “plus” apo “minus” profesionistin që kanë përballë.

Faktori qeveritar duhet të kthejë kokën nga këta 10 mijë profesionistë të lirë e të kuptojë se në epokën ku jemi futur, nuk mund të ecet me statistika që, edhe nëse i mbushin, nuk do t’i gënjejnë dot “kapitujt” përfrues me BE-në, sepse në Evropë nuk futesh dot vetëm me çekiçin e një drejtësie “spartane”, por me gjithë ingredientët që e bëjnë drejtësinë t’i shërbejë qytetarit e jo vetëm të godasë “armikun” e tij keqbërës. Dhe një nga ingredientët që e afrojnë drejtësinë me jetën e qytetarit, janë shërbimet e lira që ofrohen nga profesionistët e fushave të ndryshme, jo vetëm juridike apo ligjore.

Ndaj, ky forum le të shërbejë edhe si një thirrje miqësore “Për ndërgjegjësimin qeveritar mbi rëndësinë e profesioneve të lira në Shqipëri”.

Iniciativa jonë që po nis sot nëpërmjet këtij forumi me katër profesionet e lira ligjore, nuk përjashton askënd brenda saj. Ashtu si formësuam një modul bashkëpunimi mes nesh, përse të mos bëjmë një më të gjerë mes të gjitha profesioneve të lira në Shqipëri. P.sh. një “Union” ku të gjithë të përfaqësohen brenda identitetit të tyre profesional. “Unioni i Profesioneve të Lira Shqiptare” do të ishte një organizatë shumë më e fortë sesa vetë organizimet tona të veçanta. Një union i përbashkët do të mbronte një interes të përbashkët akoma më fuqishëm sesa mundësitë që kanë dhomat, urdhrat apo shoqatat e veçuara. Do të ishte një lloj “NATO”-je e profesioneve tona dhe kuptimi i këtij akronimi në këtë rast duhet huazuar thjesht për simbolikën e përbashkimit që tregon dhe jo për synimet apo efektet militare.

Po e përfundoj fjalën në hapjen e siparit të këtij forumi, me shpresën se kam përcjellë në emër të organizatorëve mesazhin e kuptuar të thirrjes së tij, por edhe me bindjen se ky Forum i Parë do të ndiqet nga të tjerë më pas.

Ju faleminderit!